



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

20.04.2010

01/489



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Në mbështetje të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 50.3, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr.03/L-040) nenit 12,17 shkronja (e,f), 40.2 shkronja (a) si dhe duke u mbështetur në nenin 10.1 shkronja (d,f),12 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur më 12/04/2010, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E
PËR MIRMBAJTJEN E PASTËRTISË NË TERRITORIN E KOMUNËS
SË MALISHEVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Në këtë Rregullore përcaktohen masat mbi sigurimin dhe mbajtjen e higjienës, e të pastërtisë në sipërfaqet publike dhe në sipërfaqet tjera, me qëllim të mbrojtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve, dhe të sigurimit të kushteve themelore higjienike në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

Neni 2

Sipërfaqe publike,në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje ,konsiderohen:

1. rrugët ,tregjet,vendbanimet në qytet dhe fshatra,ura,lumenjt dhe brigjet e tyre;
2. Stacioni dhe vendndaljet e autobusëve,vendparkingjet e autotaksive,pompat e benzenës dhe sipërfaqet e parkingut;
3. tregjet,parqet , sheshet dhe gjelbërimet e tjera;
4. Institucionet publike,terrenet sportive dhe zbavitëse(stadiumet,palestrat dhe objektet e tjera sportive);
5. objektet e banimit kolektiv,banjot dhe nyjet sanitare,siperfaqet tjera konsiderohen të gjitha ato sipërfaqe,pastërtia e të cilave rregullohet me këtë Rregullore;
6. Varrezat, lapidarët dhe varrezat e dëshmorëve si dhe hapsirat e tyre.

Neni 3

Në kuadrin e mbajtjes së pastërtisë e të higjienës, në pajtim me këtë Rregullore hyjnë:

1. Pastrimi i sipërfaqeve publike, spërkatja e rrugëve dhe të trotuareve, largimi i dëborës dhe i akullit nga rrugët e veçmas nga rrugët kryesore, mirëmbajtja e pusetave (sharteve), e vendërrjedhave të ujit nëpër rrugët dhe shtigjet e parkimit, grumbullimi gjegjësisht bartja e mbeturinave dhe ndotësirave tjera, mbledhja dhe largimi i kafshëve e i shpezëve të ngordhura dhe të ndotësirave tjera.
2. Bartja dhe deponimi i mbeturinave të ekonomive familjare, i ndotsive dhe mbeturinave të tjera nga ndërtesat e banimit e zyret e punës, respektivisht nga sipërfaqet e tjera, pronarët e të cilave janë ndërmarrjet punuese, pronarët e lokaleve afariste e zejtare, pastrimi dhe mirëmbajtja e vendndërtimeve, bartja dhe transporti i plehrave natyrale dhe i plehrave tjera në deponi.
3. Rregullimi higjieniko-sanitar i automjeteve të destinuara për transportin publik të udhëtarëve dhe të artikujve ushqimorë, transportin e të sëmuarëve.
4. Transportimi i lëndëve djegëse, respektivisht transportimi i materialit djegës, ndërtimor dhe i materialit tjetër (i dheut, i ngjyrës, gëlqerës, rërës, thëngjillit, drurit, plehut, mbeturinave fekale, dhe i ndotsirave tjera.)

Neni 4

Ndërmarrja përgjegjëse komunale për pastrim, ekonomitë shtëpiake, qytetarët, ndërmarrjet punuese dhe ndërmarrjet tjera, pronarët e ndërtesave, zyrtarët e zyrave të punës, lokalet afariste dhe zejtare, si dhe qytetarët që i shfrytëzojnë të gjitha hapsirat e cekura në nenin 2 të kësaj Rregulloreje janë të detyruar dhe janë përgjegjës për gjendjen e pastërtisë dhe t'i përmbahen dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe të kontribuojnë në zbatimin e saj.

II. PASTRIMI I SIPËRFAQEVE PUBLIKE DHE I VENDEVE TJERA NË QENDRËN KOMUNALE

Neni 5

5.1. Pastrimi i rrugëve, trotuareve dhe parqeve dhe i sipërfaqeve të tjera publike duhet të bëhet me kohë, dhe në mënyrë që të mos e pengoi lëvizjen e qytetarëve, kalimtarëve. Sipërfaqja që pastrohet më parë duhet të spërkatet me ujë, sidomos verës. Pastrimi i rrugëve, trotuareve, i tregjeve, dhe i sipërfaqeve tjera publike nga kompania përgjegjëse, gjatë verës duhet të bëhet pas orës 23:00, e deri në orën 06:00 të mëngjesit, ndërsa dimrit pas orës 21:00 e deri në orën 07:00 të mëngjesit.

5.2. Pronarët e lokaleve afariste dhe zejtare, banuesit e qendrave kolektive, pronarët e shtëpive të banimit, janë të obliguar që të bëjnë spërkatjen dhe pastrimin para sipërfaqeve të lokalit të tyre për çdo ditë në mëngjes deri në ora 08:00, dhe në mbrëmje pas orës 18:00.

Neni 6

Për pastrimin e sipërfaqeve të hapura ndërmjet ndërtesave apo përreth tyre, nëse ato sipërfaqe nuk i takojnë sipërfaqeve nga neni 2 i kësaj Rregulloreje ,kujdesen familjaret e ekonomive shtëpiake, ndërmarrja përgjegjëse komunale për pastrim,qiramarrësit e ndërtesave e të lokaleve të punës,bartësit e së drejtës së banuesit në ndërtesat kolektive familjare në prone publike.

Organet dhe personat nga alineja paraprake janë të detyruar që nëpërmjet të kujdestarit të ndërtesës ose në ndonjë mënyrë tjetër ta sigurojnë pastërtinë dhe gjendjen e rregullt higjienike të sipërfaqeve e të lokaleve të përmendura.

Neni 7

Për grumbullimin e mbeturinave e të pastërtisë nga sipërfaqet publike,të cilat shfrytëzohen për objekte montazha,dhe objekte të tjera të ngjajshme,stacionin e autobusëve,vendpëritjet,parkingjet e autotaksive,vendet për hyrje-dalje në terrenet sportive,për ngarkim dhe shkarkimin e mallit e të materialit tjetër nëpër shtëpi dhe depo, kujdesen,përveç ndërmarrjes përgjegjëse komunale për pastrim , edhe individët respektivisht personat fizik në llogari të të cilëve bëhet transportimi i mallit gjegjësisht ndërmarrjet punuese dhe ndërmarrjet tjera, si dhe qytetarët që i shfrytëzojnë këto hapsira.

III.MIRËMBAJTJA E PASTËRTISË NË SIPËRFAQET PUBLIKE NË QENDRËN KOMUNALE DHE NË VENDËBANIMET TJERA

Neni 8

Në sipërfaqet publike të qytetit të Malisheves dhe në vendbanimet tjera vendosen kontinjerët dhe shportat për mbeturina, nga ndërmarrja përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave .

Kontinjerët për mbeturina duhet të jenë të pajisura me kapakë, dhe të rregulluar në mënyrë që të përdoren,respektivisht të pastrohen dhe të mirëmbahen lehtë.

Neni 9

Vendet në të cilat vendosen kontinjerët dhe shportat, për mbeturina i cakton Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektoratit, me marrëveshje me ndërmarrjen përgjegjëse për pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave në tërë territorin e KK Malisheves.

Neni 10

Të gjithë qytetarët e qendrës komunale, dhe të mbarë territorit të Malishevës,janë të obliguar që t'i pastrojnë trotualet, pjesët e rrugës, si dhe sipërfaqet para dhe rreth lokaleve afariste dhe objekteve të banimit.

IV. ËSHTË E NDALUAR

Neni 11

1. Të hudhen mbeturinat ose donjë material tjetër (me dorë, karrocë, rimorkio, prej automjeteve) që krijon papastërti në sipërfaqe publike dhe në sipërfaqe tjera ;
2. Derdhja e ujërave të zeza dhe të mbeturinave të tjera në rrugë dhe në sipërfaqe të tjera publike;
3. Të lëshuarit, kullotja dhe ndalja e bagëtive jashtë vendit të caktuar për këtë;
4. Hudhja e plehut natyral (bagëtive) në sipërfaqet publike;
5. Hudhja e kafshëve të ngordhura afër vendbanimeve dhe jashtë varrezave të tyre;
6. Derdhja e ujërave të zeza dhe mbeturinave në oborre të fqinjve; ujërat e zeza ose ujërat e tjera të derdhen në gropa septike të ndërtuara për këtë qëllim, të cilat do të shërbejnë gjersa të ndërtohet kanalizimi, kjo vlen edhe për vendbanimet nëpër fshatra;
7. Pastrimi, i ndërresave, e enëve e gjësendeve, e automjeteve dhe dhënia ujë bagëtisë ku mund të krijohen dytësira të tjera në ujësjellës dhe krojet publike;
8. Rrëmihja e rrugëve publike dhe sipërfaqeve të tjera, pa lejen e organit kompetent, kjo vlen edhe për vendbanimet e fshatit;
9. Të transportohen udhëtarët në komunikacionin publik me autobus dhe autotaksi i mjeteve të transportit të produkteve ushqimore, që nuk janë në gjendje të rregullt higjienike dhe nuk disponojnë me stabilimente themelore sanitare;
10. Dëmtimi i kontinjerëve, shportave për grumbullimin e mbeturinave, si dhe të gjitha shenjave për tërheqjen e vëmendjes për mbajtjen e pastërtisë;
11. Kullotja dhe kalimi i bagëtisë nëpër qendër të urbanizuar në Malishevë;
12. Hudhja e plehrave natyrale (bagëtive), e mbeturinave tjera, afër rrugëve magjistrale dhe rrugëve nëpër fshatra.
13. Hudhja e plehrave natyrale (bagëtive), mbeturinave dhe ujërave të zeza afër ujësellsit publik, krojeve, puseve (bunarit), më afër se 30m;
14. Djegëja e mbeturinave, në kontinjer dhe sipërfaqe publike, djegëja e gomave të automjeteve, materialit plastik, dhe materialeve tjera;
15. Ndërtimi i shtallave duhet të jetë larg puseve dhe burimeve të tjera të ujit më së paku 50 m;
16. Hudhja e vajërave motorike në hapsirat publike nga personat përgjegjës të automekanikëve;
17. Vendosja e materialit ndërtimor, materialit të paperdorshëm, materialeve tjera dhe mjeteve për punë në trotuare, sipërfaqe publike, si dhe aty ku pengohet lëvizja e lirë e qytetarve;
18. Hudhja e mbeturinave të ndryshme dhe ujërave të zeza në liqen, lumë, proçka;
19. Hudhja e mbeturinave jashtë kontinjerëve nga pronarët e dyqaneve dhe qytetarve, hudhja e gjësendeve të rrezikshme në kontinjerë dhe rreth tij si dhe në hapsirat publike;
20. Lëshimi dhe lënia e kafshëve shtëpiake (e lopëve, e deleve, e dhive, dhe e kafshëve të tjera thundrake) në qytet, park, rrugë dhe në pjesë të tjera të gjelbëruara.

21. Zhvendosja e kontinjerve dhe shportave te mbeturinave pa lejen e organeve kompetente komunale dhe të kompanisë përgjegjëse;
22. Mbyllja e kanaleve anësore të rrugëve për rrjedhjen e lirë të ujërave atmosferike;
23. Derdhja e ujit nga autolarjet në rrugë.

Neni 12

Është e ndaluar çdo shitje e artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë, si dhe të produkteve tjera të përgjithshme, jashtë vendit të caktuar për shitje .

Neni 13

Ndalohet ekspozimi i produkteve ushqimore dhe jo ushqimore, dhe produkteve tjera para lokaleve afariste,trotuareve dhe sipërfaqeve tjera publike.

Neni 14

Pronarët e ndërtesave, shtëpive,atje ku nuk ka kanalizim,janë të detyruar të ndërtojnë nyje sanitare përkatëse higjienike me grop septike,ndërsa vendi për ndërtimin e tyre duhet të jetë i caktuar nga ana organi kompetent komunal.

Neni 15

Pronarët e nyjeve sanitare ,të cilët nuk i përgjigjen kushteve higjienike,gropat septike të ndërtuara në mënyrë të parregullt dhe johigjienike janë të obliguar që t'i rregullojnë sipas standardeve normale.

Neni 16

Kryerësit e punimeve ndërtimore dhe puneëve tjera janë të detyruar të kujdesen:

1. për pastrimin e sipërfaqeve publike para vendndërtimeve ku ngarkohet dhe shkarkohet materiali;
2. për stërpikjen e materialit gjatë rrëzimit të objekteve që të evitohet ngritja e pluhurit;
3. për deponimin dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga shkapërderdhja në sipërfaqe publike;
4. për pastrimin mekanik (gomave)të automjeteve para daljes së tyre në rrugë të asfaltuar nga vendndërtimi,dhe sipërfaqeve të tjera;
5. Sigurimin e vendndërtimit me rrethojë dhe me rrjet mbrojtse gjat punimeve të objekteve e sidomos nga anet e rruges që janë kryesore

Neni 17

Transportimi i materialit ngrohës (i thëngjillit,i drurit,i naftës) i materialit ndërtimor (i dheut,i rërës,i gëlqerës,i ngjyrës etj.)i mbeturinave dhe i plehut natyral, mund të bëhet me mjete transportuese të përshtatshme me rimorkio të mbuluara për këtë qëllim.

Neni 18

Pas çdo shkarkimi, respektivisht ngarkimi të materialit ngrohës, ndërtimor ose të ndonjë materiali e malli tjetër, menjëherë duhet të largohen mbeturinat dhe ndotësit e tjera.

V.BARTJA DHE DEPONIMI I MBETURINAVE TË EKONOMIVE SHTËPIAKE, SUBJEKTEVE AFARISTE DHE SIPERFAQEVE PUBLIKE

Neni 19

19.1. Ndërmarrja përgjegjëse për bartjen e mbeturinave, ujërave të zeza, është e obliguar që të bëjë kontratë me shkrim me institucionet publike, ekonomitë familjare, pronarët e subjekteve afariste, për bartjen e mbeturinave, njëherit kompania përgjegjëse është e obliguar që ti përmbahet kushteve të nënshkruara në kontratë.

19.2. Bartja e mbeturinave ,ujërave të zeza, bëhet nga ana e kompanisë përgjegjëse , mbeturinat duhet të hudhen dhe deponohen në vendin që e cakton organi kompetent komunal.

19.3. Për bartjen dhe deponimin e mbeturinave të ekonomive familjare, të lokaleve afariste e zejtare ,e të ujërave të zeza ,paguhet kompenzimi sipas çmimit të përcaktuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për këtë lëmi.

Neni 20

Mbeturinat e ekonomive shtëpiake dhe lokaleve tjera afariste dhe zejtare, duhet të hudhen në kontinjera, shporta për mbeturina .

Kontinjerët dhe shportat për mbeturina i sigurojnë dhe i mirëmbajnë, personat përgjegjës të cekur në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 21

Vendbanimet, lagjet urbane, fshatrat, dhe në vetë qytetin duhet ta kenë të caktuar vendin për vendosjen e kontinjerëve për mbeturina, me kompani përgjegjëse për mirëmbajtje të pastërtisë dhe organit kompetent komunal.

Kontinjerët e mbeturinave brenda qytetit duhet të zbrazen çdo ditë para orës 07:00, kurse në vendbanimet në fshatra të zbrazen një herë në javë.

Neni 22

Me rastin e bartjes së mbeturinave të ekonomive shtëpiake duhet pasur kujdes që në ndërtesë dhe para ndërtesës, në rrugë ose sipërfaqe të tjera publike, mbeturinat e tjera të mos shpërndahen (derdhen), të mos ngritet pluhur, të mos ndyten dhe të mos dëmtohen lokalet dhe sipërfaqet ku gjenden kontinjerët për mbeturina. Pas bartjes së mbeturinave, lokalet në ndërtesë dhe lokalet tjera, respektivisht sipërfaqja e rrugëve dhe sipërfaqet tjera duhet të mbetën në gjendje të rregullt të pastruar. Pas çdo shkarkimi të mbeturinave të tjera duhet të bëhet pastrimi i automjeteve transportuese.

Neni 23

Në të gjitha vendbanimet ku ndërmarrja komunale e autorizuar nga Komuna për grumbullim të mbeturinave shtetërore të kenë detyrë të kryejnë obligimeve për shërbimet komunale, /ujë,mbeturina/ në të kundërt nuk u kryhen shërbimet nga administrata.Keto obligime vlen edhe për subjektet afariste.

Të gjithë qytetarët janë të obliguar që me rastin e nxjerrjes së dokumentave të ndryshme në administratën komunale-shtetërore të kenë detyrë të kryejnë obligimeve për shërbimet komunale, /ujë,mbeturina/ në të kundërt nuk u kryhen shërbimet nga administrata.Keto obligime vlen edhe për subjektet afariste.

VI.LARGIMI DHE PASTRIMI I BORËS NGA RRUGËT NË TERRITORIN E QENDRËS KOMUNALE

Neni 24

24.1.Pastrimi dhe largimi i borës nga rrugët dhe arteriet e tjera të komunikacionit bëhet vazhdimisht me rastin e rënies së borës. Për pastrimin dhe largimin e borës kujdeset organi kompetent komunal, ku me procedurë të veçantë, e zgjedh kompaninë për pastrimin e rrugëve të tërë territorit të komunës së Malishevës.

24.2.Në rast të rënies së madhe të sasisë së borës ,pas konstatimit nga organet kompetente komunale,kompania përgjegjëse është e obliguar që boren brenda rrugëve të qytetit ta bartë dhe ta dërgojë jashtë qytetit në një vend ku nuk paraqet rrezik të përgjithshëm.

24.3Për largimin e borës e të akullit nga trotuarët,para lokaleve të punës,afariste e zejtarë janë të obliguar pronarët,respektivisht shfrytëzuesit e këtyre lokaleve në tërë territorin e Komunës.

Neni 25

Për largimin e borës në sipërfaqet e hapta përreth ose në mes të ndërtesave dhe nga pullazet e ndërtesave publike, kujdeset organi komunal ,respektivisht shfrytëzuesit e banesave dhe pronarët e banesave dhe ndërtesave tjera.

VII.DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 26

26.1. Subjekti afarist, personi përgjegjës i subjektit afarist, si dhe tregtarët lëvizës (e imtë) nëse hasen në kundërshtim me nenin 12 dhe 13 të kësaj Rregulloreje ka shkaktuar kundërvajtje dhe do t'i shqiptohet gjoja mandatore prej inspektorit të tregut në shumën prej 50 €.

26.2.Nëse personi që e ka bërë kundërvajtjen nuk e paguan gjobën mandatore të shqiptuar, atëherë lënda do të procedohet në Gjykatën kundërvajtëse, ku do të kërkohet që gjykata t'i shqiptojë këto dënime:

a)Personin Juridik (Subjektin afarist) 300-500 €.

b)Personin Fizik (personi përgjegjës i subj.afar) 200-300 €.

c)Tregtarët lëvizës (e imtë) 150-200 €.

26.3. Nëse edhe pas pagesës së gjobës mandatore apo mos pagesës së gjobës, personat përgjegjës e përsërisin dhe vepron kundër nenit 12 dhe 13 të kësaj Rregulloreje atëherë

malli (produktet) do të konfiskohet nga Drejtoria e Inspektoratit në bashkëpunim me Policinë e Kosovës-Malishevë.

26.4 Malli i konfiskuar do të deponohet në një depo, ku e parasheh si të nevojshme Drejtoria e Inspektoratit për ruajtjen e tij dhe, lënda do të dërgohet në Gjykatë ku do të kërkohet nga gjykata që t'i shpitoj dënimin përsonave përgjegjës sikurse në nenin 32.2 të kësaj Rregulloreje dhe njëkohësisht gjykata të jep Vendimin që malli i konfiskuar të shitet me ankand publik.

26.5. Personat juridik-personi përgjegjës i personit juridik, apo fizik (qytetarët) nëse hasen duke hedhur mbeturina në sipërfaqet publike, do të gjobiten në shumen prej:

nëse hudh me dorë-100 €, hudhja me karrocë-200 €, me automjete dhe rimorkio-500 €

26.6. Nëse personat e cekur në nenin 26.5 të kësaj Rregulloreje nuk e paguajnë gjobën mandatore, atëherë nga Drejtoria e Inspektoratit do të paraqitet kërkesa për dënim në Gjykatatën për kundërvajtje, ku nga kjo gjykatë do të denohen në shumen prej:

a) Personin Juridik (Subjektin afarist) 1000-2000 €.

b) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 500-1000

c) Personi Fizik-qytetari, 250-500 €

26.6. Mjetet financiare të fituara nga shitja e mallit nga Ankandi publik janë të hyra të jashtëzakonshme për buxhetin komunal.

Neni 27

27.1. Nëse subjektet afariste si dhe personat fizik, veprojnë në kundërshtim me nenin 11 pika, (1,2,5,6,8,9,10,12,13,14,16,19) të kësaj Rregulloreje, konsiderohet se kanë shkaktuar kundërvajtje dhe lënda do të procedohet në gjykatë për kundërvajtje, ku nga gjykata do t'i shqiptohet dënimi në shumen prej :

a) Personin Juridik (Subjektin afarist) 1000-2000 €.

b) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 500-1000

c) Personi Fizik-qytetari, 250-500 €

27.2. Nëse subjektet afariste, si dhe personat fizik, veprojnë në kundërshtim me nenin 11 pika, (3,4,7,11,15,17,18,20,21,22,23), dhe nenin 17, të kësaj Rregulloreje, konsiderohet se kanë shkaktuar kundërvajtje dhe lënda do të procedohet në Gjykatë për kundërvajtje ku nga gjykata do t'i shqiptohet dënimi në shumen prej :

a) Personin Juridik (Subjektin afarist) 500-1000 €.

b) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 300-500

c) Personi Fizik-qytetari, 250 €.

27.3. Nëse personat përgjegjës të subjekteve afariste si dhe qytetarët nuk e respektojnë nenin 14 dhe 15 të kësaj rregullore Inspektorati jep, leshon procesverbal apo aktvendim për mënjanimin e të metave nga keto nene, në afatin prej 10 ditësh, nëse kundërvajtja pas kalimit të këtij afati kohor lënda do të procedohet për gjykatë për kundërvajtje dhe do të denohen në shumen prej:

a) Personin Juridik (Subjektin afarist) 500-1000 €.

b) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj. afar) 350-500

c) Personi Fizik-qytetari, 300 €.

Neni 28

Nëse personat përgjegjës të ndërmarrjeve ndërtimore si dhe personat fizik (qytetarët) hasen nga inspektorët komunal në kundërshtim të nenit 16,18 dhe 22 të kësaj

Rregulloreje konsiderohet se kanë shkaktuar kundërvajtje dhe lenda do te procedohet në gjykatë, ku do të denohen në shumen prej

- a) Personin Juridik (Subjektin afarist) 1000-1500 €.
- b) Personin Fizik (personi përgjegjës i subj.afar) 500-1000
- c) Personi Fizik-qytetari, 500 €.

Neni 29

29.1.Nëse ndërmarrja përgjegjëse për bartjen e mbeturinave dhe ujërave të zeza,nuk i përmbahet nenit 19 dhe 20 te kësaj Rregulloreje dhe konstatohet nga inspektorët komunal, ka shkaktuar kundërvajtje,dhe me këtë rast lenda do të procedohet në gjykatën për kundërvajtje komunale ku do të denohet në shumen prej :

- a) Kompaninë përgjegjëse1000-2000 €
- b) Personin përgjegjës të kompanisë 500-1000 €.

29.2.Nëse ndërmarrja përgjegjëse për pastrimin e bores dhe të akullit nuk i përmbahet nenit 24.2 te kësaj Rregulloreje e që konstatohet nga inspektorët komunal,ka shkaktuar kundërvajtje, dhe me këtë rast lenda do të procedohet në gjykatën për kundërvajtje komunale ku do të denohet në shumen prej :

- a) Kompaninë përgjegjëse1000-2000 €
- b) Personin përgjegjës të kompanisë 500-1000 €.

29.3.Nëse ndërmarrja përgjegjëse për pastrimin e rrugëve nuk i përmbahet neit 5.1 te kësaj Rregulloreje dhe konstatohet nga inspektorët komunal, ka shkaktuar kundërvajtje,dhe me këtë rast lenda do të procedohet në gjykatën për kundërvajtje komunale ku do të denohet në shumen prej :

- a) Kompaninë përgjegjëse1000-2000 €
- b) Personin përgjegjës të kompanisë 500-1000 €.

29.4.Nëse personat përgjegjës të subjekteve afariste veprojnë në kundërshtim me nenin 5.2, dhe 24 te kësaj Rregulloreje e që konstatohet nga inspektorët komunal,kanë shkaktuar kundërvajtje, dhe me këtë rast lenda do të procedohet në gjykatën për kundërvajtje komunale ku do të denohet në shumen prej 250 €.

VIII.DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 30

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Inspektoratit.

Neni 31

Me miratimin e kësaj Rregulloreje bie nga fuqia Rregullorja Nr.213/01 e datës 04/09/2001.

Neni 32

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNES SË MALISHEVËS
Nr. 01/ 489 Datë 20 / 04 /2010



Kryesuesi i Kuvendit
Bago Begaj